



Pranuar / Dorezuar Priljezen/Prilazhen Received/Dechvety	04.05.2022	2	viti god year
Organ / Rjesia Organ / Jedinstvo Org / Unit	SKM/SHCK	2584/2022	1/4
Nr. Prot Dr. Prot Prot No		Shtypja Printoj Zpovest	Sasia Kolicina Quantity



Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
NEZAVISNI NADZORNI ODBOR CIVILNE SLUŽBEKOSOVA
INDEPENDENT OVERSIGHT BOARD FOR THE CIVIL SERVICE OF KOSOVO

A.nr.272/2022

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës-Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e ankesave në përbërje nga: Ardita Haxhnikaj-Demi-kryetare, Arben Mehmeti dhe Jeton Koca-anëtarë, me Avdyl Bekteshi-Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional në cilësinë e procesmbajtësit, ka shqyrtuar ankesën A.nr.272/2022 të datës 22.03.2022 të parashtruar nga ankuesi kundër Vendimit Nr.1474/2021 të datës 23.12.2021 të Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, në çështjen juridike "kërkesë nga marrëdhënia e punës", duke vepruar në pajtim me nenin 6 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 dhe nenin 18 paragrafin 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës dhe Rregulloren Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, në seancën për këshillim dhe votim të mbajtur me datën 04.05.2022, mori këtë:

V E N D I M

- I. Refuzohet si e pabazuar ankesa A.nr.272/2022 e datës 23.03.2022 e parashtruar nga ankuesi Tefi
- II. Mbetet në fuqi Vendimi Nr.1474/2021 i datës 23.12.2021 i Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme.

A r s y e t i m

Ankuesi i punësuar në Ministrinë e Punëve të Brendshme, më datë 22.03.2022 ka parashtruar ankesë në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, kundër Vendimit Nr.1474/2021 të datës 23.12.2021 të Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me pretendimet ankimore se vendimi në fjalë është nxjerrë me shkelje të dispozitave të procedurës dhe zbatim të gabuar të ligjit material.

Këshilli i Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil i Kosovës (me tej Këshilli) bazuar në dispozitat e Rregullores Nr.02/2018 për Procedurën e Shqyrtimit dhe Vendosjes së Ankesave në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, me datë 01.04.2022 ka kërkuar përgjigje në ankesën e ankuesit nga Ministria e Punëve të Brendshme, ndërsa Këshilli më datë 13.04.2022 ka pranuar përgjigjen në ankesë se bashku me shkresat e bashkëngjitura të lëndës.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave, për vërtetimin e plotë dhe të drejtë të gjendjes faktike si dhe vendosjes në mënyrë meritore, ka administruar këto prova: Ankesën me numër protokolli 1513/2022 të regjistruar me numër A.nr.272/2022 e datës 22.03.2022 e parashtruar nga ankuesi në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës; Emailin e datës 22.03.2022 nga ankuesi për ankesa.kpmshck@rks-gov.net; Autorizimin me Nr.925/2020 të datës 27.10.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Vendimin me Nr. 553 të datës 02.07.2021 të Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të MPB-së; Vendimin me Nr.1474/2021 të datës 23.12.2021 të Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Vendimin me Nr. 1494/2021 i datës 29.12.2021 i Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme; Kërkesën për përgjigje në ankesë e datës 01.04.2022; Përgjigjen në ankesë me Nr. Prot:2047/2022 e datës 13.04.2022; Akt Emërimit me Nr. prot:66 i datës 08.07.2013 në emër të ankuesit; Opinionin ligjo të Ministrisë së Punëve të Brendshme i datës 07.06.2021; Emailin e datës 23.12.2021 për ankuesin; Emailin e datës 22.12.2022 nga ankuesi; Emailin e datës 22.12.2021 për ankuesin; Emailin e datës 22.12.2021 nga Emailin e datës 25.11.2021 nga ankuesi; Emailin e datës 25.11.2021 nga F.Krasniqi; Emailin e datës 13.12.2021 nga Emailin e datës 08.02.2022 nga Emailin e datës 15.12.2021 nga Emailin e datës 15.12.2021 nga ankuesi; Emailin e datës 10.12.2021 për ankuesin; Emailin e datës 10.12.2021 nga Emailin e datës 03.12.2021 nga Emailin e datës 03.12.2021 nga ankuesi; Emailin e datës 30.11.2021 nga për Emailin e datës 01.11.2021 nga Emailin e datës 22.12.2021, 17.12.2021, 16.12.2021 nga për ankuesin; Emailin e datës 16.12.2021 nga Emailin e datës 16.12.2021 nga Emailin e datës 29.10.2021 dhe 28.10.2021 nga Emailin e datës 29.10.2021 nga Emailin e datës 28.10.2021 nga Emailin e datës 18.11.2021 nga për ankuesin; Emailin e datës 15.11.2021 nga Njoftim nga Emailin e datës 20.10.2021 nga Emailin e datës 24.09.2021 nga për ankuesin; Emailin e datës 10.12.2021 nga Emailin e datës 10.12.2021 nga Emailin e datës 09.12.2021 dhe 02.12.2021 nga Emailin e datës 08.12.2021, 02.12.2021 dhe 19.11.2021 nga Emailin e datës 03.12.2021 nga Plani Legjislativ për Aktet Nënligjore për vitin 2022 nga Ministria e Punëve të Brendshme.

Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pasi që ka shqyrtuar dhe analizuar shkresat e lëndës, konstaton së është e pabazuar ankesa e ankuesit , SEPSE:

Nga administrimi i provave materiale, përkatësisht sipas Akt Emërimit me numër protokolli 66 të datës 08.07.2013 rezulton se ankuesi ishte emëruar Drejtor i Departamentit për Administrimin e Shërbimit Civil në kuadër të Ministrisë së Administratës Publike. I njëjti me Autorizimin Nr.925/2020 të datës 27.10.2020 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme është autorizuar që t'i kryej detyrat e Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, deri në miratimin Rregullores së Re për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës në Ministrinë e Punëve të Brendshme, ndërsa Zëvendësuesja e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme, me Vendimin me numër protokolli 553 të datës 02.07.2021 ka caktuar ankuesin zëvendësues i Drejtorit të Departamentit për Menaxhimin e Zyrtarëve Publikë, deri në një vendim tjetër, mirëpo me Vendimin Nr.1474/2021 të datës 23.12.2021, Zëvendësuesja e Sekretares së Përgjithshëm ka bërë shfuqizimin e Vendimit Nr. 553 të datë 02.07.2021.

Në kuptim të pranueshmerisë së ankesës lidhur me afatshmerinë, e duke marrë parasysh faktin së vendimi i kundërshtuar më ankesë nuk përmban udhëzim juridik, Kolegji duke bazuar në nenin 127 paragrafi 3 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, me të cilin është përcaktuar se: *Nëse akti administrativ është lëshuar pa informacion, apo me informacion të pamjaftueshëm në lidhje me mjetet juridike administrative (këshillën juridike), afati i parashikuar nga paragrafi 1 i këtij neni, është tre (3) muaj*, konstaton së ankesa është parashtruar brenda afatit ligjor.

Ankuesi, në ankesën e parashtruar në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovë, pretendon se Vendimi Nr.1474/2021 i datës 23.12.2021 të Zëvendësueses së Sekretarit të Përgjithshëm është nxjerrë me shkelje të dispozitave të procedurës dhe zbatim të gabuar të ligjit material përkatësisht Ligjin Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe Ligjin Nr. 06/L-114 për Zyrtarët Publikë. Duke shtuar me tej së vendimi i kundërshtuar me ankesë nuk ka fare arsyetim dhe si i tillë është në kundërshtim me nenin 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative dhe së Sekretarja e Përgjithshëm është dashur që se pari të merret me zbatimin e Rregullores (ZKM) Nr.01/02021 për Organizmin e Brendshëm dhe Sistematizimin e Vendeve të Punës me Ministrinë e Punëve të Brendshme , e jo te nxjerrë vendim para komisionit të ristrukturimit .

Lidhur me çështjen në shqyrtim Kolegji sjell në vëmendje faktin se me Vendimin Nr.07-V-005 të datës 03.02.2020 të Kuvendit të Republikës së Kosovës për Zgjedhjen e Qeverisë së Republikës së Kosovës është bërë riorganizimi i ministrive ashtu që është bërë fuzionimi i Ministrisë së Administratës Publike dhe Ministrisë së Punëve të Brendshme, tani me emërtim Ministria e Punëve të Brendshme, riorganizim ky i përcaktuar edhe me Rregulloren QRK) -Nr.06/2020 për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive e ndryshuar dhe plotësuar me Rregulloren Nr.02/2021. Po ashtu me hyrjen në fuqi të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, është shuar Departamenti për Administrimin e Shërbimit Civil ku ankuesi ka ushtruar detyrën e drejtorit, ndërsa me nenin 11 të këtij ligj është themeluar Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publikë.

Lidhur me shqyrtimin e ligjshmërisë së pretendimeve të ngritura në ankesë, Kolegji ju referua dispozitave të nenit 53 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative me të cilin është përcaktuar se: *Një akt administrativ mund të anulohet apo shfuqizohet, sipas detyrës zyrtare, nga organi publik që ka kompetenca të nxjerrë aktin, nga organi i tij mbikëqyrës apo nga një organ tjetër i përcaktuar shprehimisht me ligj. 2. Anulimi i një akti administrativ ka pasoja në të kaluarën (retroaktive), ndërsa shfuqizimi i aktit administrativ ka pasoja vetëm në të ardhmen. Anulimi edhe shfuqizimi mund të jenë të pjesshëm apo të tërësishëm. 3. Anulimi apo shfuqizimi bëhen me një akt të ri me shkrim, i cili anulon, shfuqizon, ndryshon apo plotëson aktin e parë, rrjedhimisht në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe duke u bazuar në shkresat e lëndës rezulton se ankuesi me Vendimin me numër protokollit 553 të datës 02.07.2021 është caktuar si zëvendësues i Drejtorit të Departamenti për Menaxhimin e Zyrtareve Publike deri në një vendim tjetër, andaj mbi këto rrethana Kolegji konstaton se një akt administrativ i ligjshëm mund të shfuqizohet, në çdo kohë kur organi që ka nxjerrë aktin vlerëson së kanë ndryshuar rrethanat faktike ose ligjore apo për shkak të arsyeve tjera të parapara me ligj, ashtu siç është përcaktuar me nenin 57 paragrafi 1 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative.*

Kolegji konstaton së është i pabazuar pretendimi ankimor së vendimi i ankimuar është nxjerrë në kundërshtim më nenin 52 paragrafi 1 nënparagrafi 1.4 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e

Përgjithshme Administrative, sepse instituti i zëvendësimit nënkupton ushtrimin përkohshëm të pozitës së caktuar e jo sistemim të përhershëm të nëpunësit civil, andaj me shfuqizimin e vendimit më të cilin ankuesi ishte emëruar zëvendësues i drejtorit të DMZP, nuk janë cenuar të drejtat dhe interesat e tij të njohura ligjrisht me rastin e ristrukturimit të një institucioni, pasi që Ministria e Punëve të Brendshme ka të themeluar Komisionin e Ristrukturimit i cili është përgjegjës për sistemimin e çdo nëpunësi civil në pajtim me nenin 57 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 Për Zyrtarët Publike, dhe mbi këtë bazë e në kuptim të nenin 49 paragrafi 1 nënparagrafi 1.3 të Ligjit Nr.05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative, Kolegji konstaton se mungesa e arsytimit në vendimin e kundërshtuar me ankesë nuk e bën të paligjshëm këtë vendim.

Kolegji në mbështetje të nenit 24 paragrafi 3 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë konstaton se *Nëpunësi civil ka të drejtë të paraqesë ankesë drejtpërdrejtë në KPMSHCK për çdo veprim apo mosveprim, që i cenon të drejtat apo interesat e ligjshme, të drejta këto që burojnë nga marrëdhënia e Shërbimit Civil sipas këtij ligji*, ndërlidhur me këtë neni 13 i Ligji Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative parasheh se: *Përveç kur përjashtohet shprehimisht me ligj, secili person ka të drejtë të ushtrojë mjetet juridike administrative dhe ato gjyqësore, në mënyrën e përcaktuar me ligj, kundër një veprimi apo mosveprimi administrativ të organit publik që i cenon një të drejtë apo një interes juridik*. Kështu që në kuptim të këtyre dispozitave ligjore dhe duke nisur nga gjendja faktike e konstatuar si me lartë, Kolegji konstaton së ankuesi i prekur me procesin e ristrukturimit të organit të punësimit i garantohen të drejtat e përcaktuara me nenin 54 të Ligjit Nr.06/L-114 për Zyrtarët Publikë, andaj çdo veprim apo mos veprim i organit të punësimit në kundërshtim me këto dispozita ligjore përbënë shkak të ushtrimit të mjeteve juridike në Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil .

Ashtu siç u tha me sipëri, Kolegji për Shqyrtimin dhe Vendosjen e Ankesave pas analizimit dhe vlerësimit të të gjitha shkresave të lëndës, e duke u bazuar në nenin 18 paragrafi 1 nënparagrafin 1.1 të Ligjit Nr.06/L-048 për Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil të Kosovës, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit nga Kryetarja e Kolegjit.

Këshillë juridike: *Kundër vendimit të Këshillit, pala e pakënaqur mund të iniciojë konflikt administrativ në Gjykatën Themelore në Prishtinë -Departamenti për Çështje Administrative, brenda afatit prej tridhjetë (30) ditësh nga dita në të cilën i është dorëzuar vendimi. Inicimi i konfliktit administrativ nuk ndalon ekzekutimin e këtij vendimi.*

KËSHILLI I PAVARUR MBIKËQYRËS PËR SHËRBIMIN CIVIL TË KOSOVËS
Lënda me numër A.nr.272/2022

Avdyl BEKTESHI

Zyrtar i Lartë për Bashkëpunim Profesional

Ardita Haxhnikaj-DEMI

Kryetare e Kolegjit

Vendimi i dërgohet

- Ankuesit
- Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve të Brendshme;
- Udhëheqësit të Burimeve Njerëzore në Ministrinë e Punëve të Brendshme dhe;
- Arkivit të KPMSHCK-së.